



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:184291
Datë: 20.03.2024
Numri i dokumentit: 05476849

Ac.nr.3893/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Bislimaj, kryetar i kolegjit, Hidajete Gashi Alaj dhe Kujtim Pasuli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses F. Sh. nga Ferizaj, të cilën me autorizim e përfaqësojnë av. M. S. dhe av. B. S. nga Prishtina rr. “UQK-së”, Hyrja 261 kati I, nr.5, kudër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Siguria” me seli në Prishtinë, me objekt kontestit kompensim dëmi, duke vendosur sipas ankesës së paditëses, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1978/2020, datë 18.04.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 20.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET poshtë si e paafatshme ankesa e paditëses F. Sh. nga Ferizaj, e datës 02.06.2022, e parashtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1978/2020, datë 18.04.2022.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e atakuar me numër C.nr.1978/2020, datë 18.04.2022, gjykata e shkallës së parë ka vendosur: I. Gjykata Themelore në Ferizaj, SHPALLET JOKOMPETENTE në pikëpamje territoriale për procedimin e kësaj çështje juridike. II. Pasi që të bëhet i formës së prerë ky aktvendim, padia i dërgohet në kompetencë Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi ankesë ka parashtruar pala paditëse duke mos i përmendur shkaqet e parapara me ligj për paraqitjen e ankesës, me pretendimet se vendimi i ankimuar me të cilin është shpallur jo kompetente gjykata përbën shkelje flagrante për rastin konkret pasi që në këtë rast bëhet fjalë për lëndime të rënda trupore e për të cilat arsye i ka propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës që ta aprovojë ankesën e paditëses ndërsa aktvendimin e ankimuar ta anulojë dhe çështjen t’ia kthejë të njëjtës gjykatë në procedim të mëtutjeshëm të lëndës.

Nga shkresat e lëndës nuk mund të gjendet se e paditura të ketë paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka vlerësuar se:

-Ankesa e paditëses është e paafatshme.

Gjykata e Apelit të Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, duke vlerësuar lejueshmërinë dhe afatshmërinë e ankesës së parashtruar nga pala paditëse, përkatësisht me shikimin në fletë kthesën për dorëzim personal, vërtetoi faktin se paditësja aktvendimin e atakuar të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1978/2020, datë 18.04.2022, e ka pranuar përmes të autorizuarit të saj me datë 27.04.2022 ndërsa ankesën kundër aktvendimit e ka dorëzuar në gjykatë me datën 02.06.2022, pas kalimit të afatit 15 ditë për paraqitjen e ankesës. Si datë e fundit për paraqitjen e ankesës ka qenë data 12.05.2022, që do të thotë se ankesa e paditëses është paraqitur pas afatit të paraparë ligjor dhe se për të njëjtën nuk ka prova në shkresa të lëndës se është dorëzuar nëpërmjet postës.

Pasi që afati për ankesë sipas aktvendimit të ankimuar ka qenë 15 ditë, nga dita e pranimit të aktvendimit, atëherë rezulton që ankesa është dorëzuar pas skadimit të afatit prej 15 ditësh, për faktin se afati fillon të llogaritet nga data 28.04.2022 dhe kur llogariten 15 ditë, atëherë dita e fundit për parashtrimin e ankesës ka qenë data 12.05.2022 (ditë e enjte). Andaj, në bazë të cekurave dhe duke marrë për bazë se afati për ankesë është afat prekluziv, Gjykata e Apelit vendosi duke u bazuar në nenin 186 paragrafi 2, të LPK-së, sipas të cilit ankesa është e paafatshme po që se është paraqitur pas skadimit të afatit ligjor për paraqitjen e saj, si dhe nenit 196, të LPK-së, ku është përcaktuar se: *“ankesën e vonuar, jo të plotë, apo të palejueshme, e hedhë poshtë gjykata e shkallës së dytë me aktvendim, po që se nuk e ka bërë një gjë të tillë gjykata e shkallës së parë siç është parashikuar në (nenin 186)”*, andaj pasi që në rastin konkret gjykata e shkallës së parë nuk e ka vlerësuar afatshmërinë e ankesës dhe të njëjtën nuk e ka hedhur si të paafatshme, sipas ligjit vendosi gjykata e shkallës së dytë.

Nga sa u tha me lartë, Gjykata e Apelit e Kosovës në kuptim të dispozitës së nenit 195 par.1 pika a) dhe nenit 196 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.3893/2022, datë 20.03.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,
Besnik Bislimaj